




*Bell*Tours

LAOS, VIETNAM, KAMBOXHIA
26 SHKURT – 12 MARS 2025



DITA 1:

27 SHKURT

VIENTIANE (LAOS)


Mbërritja - Vientiane (Laos). Mirëseardhja në aeroport pas mbërritjes në Vientiane kryeqyteti i Laosit. Transferimi për në hotel dhe pushim. **Akomodimi në Vientiane.**



DITA 2:



28 SHKURT

VIENTIANE - LUANG PRABANG



Mëngjesi në hotel. Në mëngjes do të eksploroni qytetin, me vizitën e vendeve kryesore të kryeqytetit; duke përfshirë tempujt më të vjetër; **Wat Ongtue dhe Wat Sisaket** me mijëra statuja miniaturë të Budës. Do të vizitoni ish tempullin mbretëror të **Wat Prakeo**, i cili më parë strehonte imazhin e famshëm të Budës Emerald. Ndalesë te tregu i mëngjesit, i cili ka një sërë

produktesh dhe suvenire, do të vizitoni simbolin kombëtar të Laos; **That Luang Stupa e shenjtë**, do të keni gjithashtu mundësinë të bëni disa fotografi të **Monumentit të Patuxay**, i cili njihet mirë si Harku i Triumfit të Vientianes. Pasdite, vizitë te **Buddha Park**. Ky park skulpture arti ndodhet rreth 27 km në juglindje nga Vientiane dhe është një vend i mrekullueshëm e intrigues. Të vendosura në një livadh buzë lumit Mekong, **statujat e çimentos** janë njëkohësisht të



zbukuruar dhe ndonjëherë të çuditshme, megjithatë të admiruara për veprat e artit. Në vijim, kthimi në qytet dhe transferimi në stacionin e trenit për trenin **EMU C84 @ 15:55/ 18:16** për në **Luang Prabang**. Pritja në stacionin e trenit në Luang Prabang dhe transferimi në hotel për check in. **Akomodimi në**

Luang Prabang.

Këtë mëngjes ju ftojme të zgjoheni herët dhe të merrni pjesë në **ritualin e përditshëm të mëngjesit të hershëm të murgjve** të veshur me rrobë ngjyrë shafrani, me kupa të tyre teksa u jepen lëmoshë nga banorët vendas, duke përfshirë orizin të kudondodhur. Pas



mëngjesit në hotel, do të vizitoni **Wat Visoun**: një kopje e një tempulli të vjetër, i cili u ngrit në të njëjtin vend në vitin 1513 duke strehuar thesare të shumta të artit fetar. Më pas shkojmë në **Wat Xieng Thong**, një Wat mbretëror i ndërtuar në brigjet e lumit Mekong në vitin 1559. Wat Xieng Thong ka mbetur relativisht i padëmtuar nga pushtimet e ndryshme, kryesisht kineze gjatë shekujve.

Tempulli është dekoruar gjerësisht me gdhendje mbresëlënëse, murale dhe mozaikë. Do të vizitoni **Pallatin Mbretëror të Laosit** i njohur zyrtarisht si Haw Kham. Pallati u ndërtua gjatë epokës koloniale franceze për Mbretin dhe familjen e tij. Vendi u zgjodh në mënyrë që vizitorët zyrtarë në Luang Prabang të mund të zbrisnin nga udhëtimet e tyre në lumë, direkt në pallat dhe të priteshin atje. Në vitin 1975, monarkia u përmbys dhe Pallati u shndërrua në një muze kombëtar. Më pas, transferimi në aeroport për fluturimin drejt Hanoit (koha e fluturimit për t'u përcaktuar) **Pritja në aeroport në Hanoi dhe më pas transferimi në hotel. Akomodimi në Hanoi.**

Mëngjesi në hotel. Një turne njëditor në qytet për të vizituar sheshin historik **Ba Dinh me mauzoleumin Ho Chi Minh** (nëse është i hapur), **Shtëpinë Ho Chi Minh Stilt** dhe **One Pillar Pagoda**, më pas do të vizitoni **burgun Hoa Lo**. Pasdite do të vizitoni **Sektorin Qendror të Kështjellës Perandorake të Thang Long**




(i ndërtuar në shekullin e 11-të dhe i njohur si **sit i trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s**) (mbyllur të hënave) dhe **Tempullin e Letërsisë** (i themeluar në fillim të shekullit të 11-të dhe konsiderohet si universiteti i parë i Vietnamit). Më pas do të shijoni një orë me **biçikletat karakteristike në lagjet e**

vjetra të Ha Noi me mbi një mijë vjet histori, pasuar nga një shfaqje spektakolare në ujë, me kukulla, në mbrëmje. Akomodimi në Hanoi.


Mëngjesi në hotel. Më pas do të udhëtoni në gjirin e mrekullueshëm **Lan Ha** (205 km / 3 orë), **pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s**, përmes provincave veriore si Nam Dinh, Thai Binh etj.

Gjiri Lan Ha, pjesë jugore e Gjirit Ha Long, ende ruan bukurinë natyrore dhe më pak të mbushur me njerëz se Gjiri Ha Long ose Gjiri Bai Tu Long. Bukuria e Gjirit Lan Ha është po aq e madhe sa Gjiri Ha Long, i cili është një zgjedhje e shkëlqyer për ata që duan të eksplorojnë peizazhin gëlqeror, por dhe të zhyten në zonën e qetë të Gjirit.



Pas mbërritjes në **Tuan Chau**, do të bëni check in në anijen Peony dhe do të shijoni programin e lundrimit në gjirin e bukur Lan Ha.

Ndërsa anija niset, ju do të përshëndeteni nga Ekuipazhi i anijes Peony dhe Menaxheri i anijes, të cilët janë të angazhuar që gjatë qëndrimit tuaj t'ju ofrojnë standardet më të larta të shërbimit.



Pas drekës në bord, do të vizitoni **shpellën Dark and Bright** me varkë bambuje dhe do të shijoni notin në ujin e pastër ngjyrë smeraldi. Më pas do të ktheheni në anije dhe do të shijoni perëndimin e diellit në kuvertën e sipërme ose mund pushoni në mini pishinën me Jacuzzi. **Një darkë elegante Gala** do të shërbehet në restorantin ku mund të shijoni

bukurinë e gjirit Lan Ha gjatë natës. **Akomodimi në bordin e anijes**, në Gjirin Lan Ha.

Do ta filloni ditën me **seancë Tai Chi** me lindjen e diellit në agim, në gjirin Lan Ha, më vonë do të shijoni në restorant një mëngjes të lehtë me biskota, çaj dhe kafe. Pas kësaj, ju do të vizitoni zonën e **Frog Pond** ku mund të bëni kajak dhe të relaksoheni në mini pishinën natyrore në gjirin Lan Ha. Më pas do të ktheheni në



anije dhe do të shijoni brunch në anijen Peony ndërsa niseni për në Tuan Chau. Pritja nga anija dhe transferimi drejt aeroportit për **fluturimin e brendshëm në Da Nang** (koha e fluturimit për t'u përcaktuar). Pritja në aeroportin e Da Nang dhe më pas transferimi në hotel në Hoi An. **Akomodimi në Hoi An.**



Mëngjesi në hotel. Në mëngjes mund të shëtisni rreth qytetit të bukur dhe paqësor **Hoi An** - një tjetër vend i Vietnamit, **trashëgimi botërore e UNESCO-s** - për të vizituar shtëpitë e vjetra, tregun lokal, sallat e asamblesë kineze dhe urën e mbuluar japoneze. Më pas, ekskursion për të vizituar **My Son Holy Land** i ish-



Mbretërisë Champa, e cila është **njohur së fundmi si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore** - ky vend dikur ishte qendra fetare dhe intelektuale e Mbretërisë Champa gjatë periudhës së lulëzimit të saj nga shekujt 4-13. Do të vizitoni tempujt e mbetur për të shijuar aftësitë e popullit Cham në ndërtimin e këtyre strukturave dhe dekorimet e gdhendura në to. Pas kësaj, do të udhëtoni në Hue për të



qëndruar gjatë natës. **Akomodimi në Hue.**

Mëngjesi në hotel. Një ditë e plotë **vizite rreth qytetit dhe vizitë e ish-Kështjellës Perandorake të dinastisë Nguyen** nga viti 1805 deri në 1945 – një **vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s**, do të vizitoni **varrin madhështor të Khai Dinh dhe Mbretit Minh Mang**, më pas do të vizitoni **faltoren Thien Mu** të





ndërtuar në 1601 e cila është një nga Tempujt më të vjetër fetarë në Vietnam, duke shijuar shëtitjen me varkë në lumin Parfum. Pritja në skelë dhe transferimi në hotel për t'u çlodhur. **Akomodimi në Hue.**

Mëngjesi në hotel. Më pas, transferimi në aeroport për fluturimin drejt Saigon (koha e fluturimit për t'u përcaktuar). Pritja në aeroport dhe transferimi për të vizituar **Sallën e Mbetjeve të Luftës, Sallën e Ribashkimit.**




Ndalesë për foto në Katedralen Notre Dame, në Postën e Përgjithshme dhe Bashki. Kthimi në hotel dhe pushim. **Akomodimi në Saigon.**

Mëngjesi në hotel. Nisje drejt **deltës pjellore Mekong** nga e cila prodhohet pjesa më e madhe e orizit të Vietnamit, duke e konsideruar "shporta e orizit" e Vietnamit. Do të mbërrini në **qytetin Ben Tre** dhe do të hipni në varkë, si dhe do eksploroni aktivitete përgjatë lumit, si peshkimi... dhe do të vizitoni **punëtorinë e prodhimit të tullave në stilin tradicional** dhe **punëtorinë e përpunimit të kokosit**. Më pas do të mbërrini në fshat ku do të vizitoni **punëtorinë familjare** që bëjnë dyshekë gjumi, si dhe do të shijoni fruta dhe çaj të stinës. Pas kësaj, do të merrni tuk tukun lokal përgjatë shtigjeve të fshatit për të shkuar për drekë në një shtëpi lokale; më pas do të shijoni ecjen me varkë përgjatë kanalit të vogël përpara se të ktheheni në skelë për të shkuar në **Chau Doc**, ku do të qëndroni gjatë natës. **Akomodimi në Chau Doc.**



Mëngjesi në hotel. Më pas, transferimi në molin e varkave, ku do të bëni një **udhëtim me varkë me shpejtësi të madhe në lumin Mekong** për në Phnom Penh (rreth 5-6 orë), nëpërmjet Vinh Xuong (kufiri Vietnam - Kamboxhia) (pa guidë). Pas mbërritjes në Phnom Penh, pritja në port dhe transferimi në hotel për check-in. Pasdite do të vizitoni **Pallatin Mbretëror** të ndërtuar nga Mbreti

Norodom në 1866 në zonën e qytetit të vjetër dhe **Faltoren e Argjendtë**. E vendosur brenda territorit të Pallatit Mbretëror,





Faltorja e Argjendtë është emëruar për shkak të dyshemesë së saj, e cila përbëhet nga 5000 pllaka argjendi. Thesaret e gjetura brenda përfshijnë një Budë prej ari të ngurtë të veshur, që peshon 90 kilogramë

dhe një Buda të vogël të shekullit të 17-të smeraldi dhe kristali. Më pas do të eksploroni **Muzeun Kombëtar** të dedikuar ekskluzivisht **artit dhe skulpturës Khmere** të datuara që nga shekulli i 4-të deri në shekullin e 15-të. Do të vijoni të vizitoni **tempullin Wat Ounalom dhe Wat Phnom**, i cili shpjegon historinë e emrit të Phnom Penh. **Akomodimi në Phnom Penh.**

DITA 12: 10 MARS**PHNOM PENH – SIEM REAP (KAMBOXHIA)**

Mëngjesi në hotel. Udhëtim drejt Siem Reap për rreth 6 orë dhe gjatë rrugës do të vizitoni **fshatin lokal të gdhendjes, urën antike si dhe tempujt e rinj të trashëgimisë botërore të UNESCO-s Sambor Prei Kuk** të periudhës para-Angkor në Provincën Kampong Thom. Pas mbërritjes në Siem Reap, check in në hotel dhe pushim. **Akomodimi në Siem Reap.**

**DITA 13: 11 MARS****SIEM REAP**

Mëngjesi në hotel. Do të filloni turin tuaj të plotë ditor të vizitave në zonën e Angkor me **Portën Jugore të Angkor Thom**, e cila është e famshme për serinë e saj të fytyrave kolosale njerëzore të gdhendura në gur, tempullin mbresëlënës Bayon, Rrethimin Mbretëror, Phimeanakas, Tarracën e Elefantit, Tarracën e Mbretit Leper dhe tempullin Ta Prohm të mbuluar

nga xhungla. Pasdite do të vizitoni tempullin më të madh dhe më të kompletuar të **Angkor Wat** me shumë galeri me kolona, biblioteka, pavijone, oborre dhe pellgje plot me ujë që pasqyrojnë tempullin e lartë. Darkë në restorant lokal me valle Apsara. **Akomodimi në Siem Reap.**



Mëngjesi në hotel. Në mëngjes do të vizitoni **fshatin lundrues Kampong Khleang**



në liqenin Tonle Sap, i cili është më i largët dhe më pak turistik se fshati Kampong Pluk, ku do të merrni varkën për të vizituar mënyrën e jetesës së të varfërve kamboxhianë së bashku me shkollat, restorantet, spitalet dhe shumë më tepër, që lundrojnë në liqenin e madh të Tonle Sap. Më pas, transferimi drejt aeroportit për fluturimin

ndërkombëtar të kthimit në shtëpi (koha e fluturimit për t'u përcaktuar).

<Fundi i shërbimeve>

PËRFSHIHEN NË ÇMIM:

- Biletat e avionit Tiranë – Vientiane, me valixhe 20 kg;
- Biletat e avionit Siem Reap - Tiranë, me valixhe 20 kg;
- 3 bileta avioni për fluturimet e brendshme: Luang Prabang (LPQ)– Hanoi (HAN); Hanoi (HAN)- Da Nang (DAD); Da Nang (DAD) – Saigon (SGN);
- Akomodimi në hotel 5* me mëngjes të përfshirë;
- 1 mëngjes +1 drekë + 1 darkë +1 brunch në anijen Halong (pa pije);
- 10 dreka + 11 darka në restorantet lokale sipas itinerarit (pa pije);
- Transferta private me autobus me ajër të kondicionuar sipas itinerarit;
- Udhëtimi me anije në Luang Prabang, Mekong Delta and Hue;
- Bileta e trenit të shpejtë Vientiane – Luang Prabang;
- Bileta e anijes së shpejtë Chau Doc – Phnom Penh;
- Biletat e hyrjeve për vizitat e specifikuara sipas itinerarit;
- Guida lokale në anglisht (përveçse në kohën e lirë dhe në anije në Halong);
- Guidë lokale në anglisht në anijen Halong;
- 1 (një) shishe ujë mineral në ditë;
- Siguracioni i shëndetit në udhëtim.

NUK PËRFSHIHEN NË ÇMIM:

- Vizat në kufi dhe tarifa e pullës;
- Pijet dhe ushqime të tjera extra;
- Bakshishet;
- Shpenzimet personale
- Vizitat opsionale;
- Çdo shpenzim tjetër që nuk përmendet më sipër.